

MARS 2024

TAKIM ME NDIHMËS SEKRETARIN E SHTEJIT PËR ÇËSHTJET NDËRKOMBËTARE TË NARKOTIKËVE DHE TË ZBATIMIT TË LIGJIT, TODD ROBINSON



Ministri Manja ritakohet në Tiranë me Ndihmës Sekretarin e Shtetit për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit, Todd Robinson. Mes miqve u diskutua hapur për problemet, por dhe për mbështetjen për t'i zgjidhur ato në interesin më të mirë të qytetarëve shqiptarë. Manja u shpreh falenderues ndaj SHBA për mbështetjen e reformës në drejtësi, shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit!

SHQIPËRIA BASHKON BALLKANIN PERËNDIMOR NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë me Ministrinë e Administratës Publike dhe Antikorrupsionit dhe Iniciativën Globale Kundër Krimit të Organizuar Transnacional (GI-TOC) kanë bërë bashkë në Tiranë, Ministrat e Drejtësisë së Ballkanit Perëndimor, prokurorë, organizata ndërkombëtare, shoqëri civile, media dhe agjenci të ndryshme antikorrupsion, të cilët bashkuan forcat në konferencën "Forcimi i Llogaridhënies: Fuqizimi i përpjekjeve kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor", duke shprehur përkushtimin për luftën kundër korrupsionit. Hapi i parë drejt një agjende të përbashkët rajonale!



MODERNIZIMI DHE PROJEKTET E REJA: MINISTRIA E DREJTËSISË BËN BASHKË DONATORËT DHE AKTORËT KRYESORË TË ORGANEVE TË REJA TË DREJTËSISË

Ndërtimi i një sistemi drejtësie modern në Shqipëri po bën hapa të rëndësishëm përpara! Në këtë takim u bënë bashkë, Ministria e Drejtësisë, SASPAC, drejtuesit e organeve të reja të drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës, diplomatë të vendeve të BE-së, zyra e delegacionit të BE-së, përfaqësues nga Ambasada Amerikane, Britanike, si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që mbështesin prej vitesh Reformën në Drejtësi, për të koordinuar mbështetjen e projekteve për modernizimin, aksesin dhe transparencën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

